



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER**

Nr. 1840/1 Prot.

Fier, më 22.11.2022

RISHPALLJE 5

E VENDIT TË LIRË PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr.99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimin nr.2, datë “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, DRAP Fier shpall vendet e lira të punës si drejtues institucionesh arsimore në ZVAP-ve në juridiksionin e saj sipas listës bashkëlidhur:

1. Aplikantët e intereuar për pozicionet e drejtuesve të institucioneve arsimore duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” me vlerësimin jo më pak se “mirë”, në kualifikimin e fundit.
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar ose të jetë pranuar për ta kryer atë.

2. Aplikantët për pozicionin e drejtorit në IPAP duhet të dorëzojnë.

- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;

c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetim nga shkolla e drejtorëve që është pranuar për të kryer trainimin e detyrueshëm.

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2, dorëzohet nëpërmjet **shërbimit postar** në ZVAP-në përkatëse ku ndodhet shkolla në të cilën aplikanti këkon të konkurojë.

Datat fazave brenda procedurës.

1. **Dërgimi me postë nga data 23.11.2022 deri 03.12.2022**
2. Mbledhja e komisionit brenda datës 07.12.2022
3. Hartimi i listës për vlerësim pas verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data **14.12.2022**. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.
4. Brenda datës **19.12.2022**, Komisioni shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelën e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6 , bashkëlidhur këtij udhëzimi.
5. Afatet e ankimimit nga kandidatet, për komisionin janë deri më datë **22.12.2022**. **Brenda datës 23.12.2022**, Komisioni duhet tu kthejë përgjigje ankimuesve.
6. Kryetari i Komisionit dorëzon Drejtorit të ZVAP dosjet për dy kandidatët me më shumë pikë.
7. Drejtori i ZVAP, pas shqyrtimit të dokumentacionit në ZVAP-in përkatës, përcjell dokumentacionin për dy kandidatët me më shumë pikë në DRAP, brenda datës **27.12.2022**.
8. Drejtori i DRAP, brenda datës **06.01.2023**, interviston dy kandidatët dhe brenda datës **09.01.2023**, shpall vendimin për kandidatin fitues, për pozicionin e drejtorit të IPAP.
9. Kandidati jofitues ka të drejtën e ankimit në MAS brenda 3(tre) ditë punë nga shpallja e kandidatit fitues.

10. MAS brenda 10 ditëve pune kthen përgjigje ankesës.

Në përfundim të të gjithë fazave të mësipërme, Drejtor i DRAP, bën emërimin e drejtorit të IPAP.

Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar.
- Vendimit nr.99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.
- Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,
- Ligji nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,
- Ligjit 9667, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e ushtrimin e funksioneve publike”
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimin nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Udhëzimin “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”,
- Udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”,
- Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit parauniversitar.

Bashkëlidhur lista me vendet vakante për cdo ZVAP

DREJTOR

FLUTURA MECAJ





GRAFIKU I KONKURSEVE PER DREJTOR TE IPAP

RISHPALLJA 5

Nr	Shkolla	ZVA
1	KONGRESI I LUSHNJES	LUSHNJE